




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1.1, lidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të datës 26.03.2009 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009”) dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, në mbështetje të nenit 44 dhe nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016”) dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve brenda afatit ligjor, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R
Mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar

1. **MIRATOHET** kërkesa e subjektit kërkues, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik për vendosjen e trafos elektrike në lagjen “Vëllezërit Frashëri” në Rahovec, si vijon:
- Pjesën e parcelës P-71510057-01728-1 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 9m² (nëntë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 430m² (katërqind e tridhjetë metra katror) në vendin e quajtur *strane*, me kulturë: Kullosë e klasës II, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në emër të Agim (Xhafer) Kastratit.
2. Vërtetohet se vendosja e trafos elektrike në lagjen “Vëllezërit Frashëri” në Rahovec, është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe që shpronësimi i paluajtshmërisë së lartcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.
3. Pronari i parcelës kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të kompensohet konform dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ndryshim-plotësimin të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-205, i datës 10.12.2010.
4. Vendimin preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgojë zotëruesit të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se iu takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.
5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës, pas miratimit të vendimit preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në një gazetë zyrtare me tirazh më të madh, në Republikën e Kosovës dhe ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ar sy e t i m

Subjekti kërkues – Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit, me kërkesën me Nr. Prot. 2180, të datës 11.7.2024, ka kërkuar iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik për vendosjen e trafos elektrike në lagjen “Vëllezërit Frashëri” në Rahovec.

Subjekti kërkues i kësaj kërkesë ia ka bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitën e nenit 8 lidhur me nenin 4 të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Organi shpronësues, pas shqyrtimit të kërkesës, ka ardhur në përfundim se shpronësimi i paluajtshmërisë së evidentuar në dispozitiv të këtij vendimi preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim dhe që shpronësimi në fjalë nuk prek të drejtat private, se pjesa e pronës së paluajtshme, e cila është objekt shpronësimi, nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimit diskriminues dhe se organi shpronësues lidhur me këtë çështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

Organi shpronësues – kryetari i Komunës, me vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim me Nr. Prot. 2180, të datës 11.7.2024, ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues – Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik.

Po ashtu, organi shpronësues, në bazë të nenit 4 dhe nenit 10 të këtij Ligji, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, shpall në gazetë zyrtare me tirazh më të madh, në Republikën e Kosovës.

Vendimin preliminar, organi shpronësues, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, do t’ia dërgojë pronarit, zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë që pretendojnë se u takon ndonjë e drejtë në pjesën e parcelës së shpronësuar në bazë të nenit 10, paragrafi 3 të këtij ligji.

Prandaj, duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, në afat prej 15 ditëve kalendarike, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Subjektit kërkues – DGJKP-ja,*
- *Pronarit dhe zotëruesit e interesit, dhe*
- *Arkivi.*

